

Jetojmë kështu...

Programi: Bashkimi

CHIARA LUBICH

Lufta e Dytë Botërore , Trento (Itali).

Në një strehimore, të ndihmuar nga drita e një qiriri, hapëm Ungjillin.

Një ditë në Ungjillin sipas Gjonit, lexuam këtë frazë: “Të gjithë jemi Një”

Dhe unë thashë: “Ky është programi ynë: ne jetojmë në këtë botë sepse të gjithë jemi Një”

Për këtë faqe të Ungjillit kemi lindur, domethënë, për të sjellë bashkim në botë, bashkimi me Hyjin është bashkim midis nesh: vëllezër.

Po çfarë duhej bërë për të sjellë Bashkim? E kuptuam: Ne duhet ta donin njëri-tjetrin sikur Jezusi të ishte gjithmone midis nesh

Dhe për faktin se Ai ishte atje , ndjehej një gëzim i madh, i paprovuar kurrë më parë, një paqe e re, një adore e re; drita e tij na udhëhiqte.

Dhe, pse Jezusi ishte midis nesh? Sepse njerëzit përreth nesh përqafojnë dhe ripërqafojnë besimin tonë; njerëz të çdo moshe, të çdo kategorie sociale, të çdo profesioni.

Filloi kështu të realizohej ëndrra e Jezusit, për të cilën iu përgjërua Atit para se të vdiste: “Atë: Të gjithë, të jemi Një”.

FJALA E JETËS | 11

«Të gjithë jemi një Trup i vetëm» (Gv 17, 21)

Kaitulli 17 i Gjonit është një lutje e gjatë që Jezusi i drejtoi Atit pak para se të vdiste. I kërkoi një gjë që e kishte aq shumë për zemër. Zoti, në fakt: e krijoi njerëzimin si familje të tijen, me të cilën ndan çdo të mirë, jetën e tij hyjnore. Çdo familje mbart gjurmë të prindërve. Kështu është edhe familja e krijuar nga Zoti.

Kur krijoi njerëzimin, ai krijoi imazhin dhe shëmbëlltyrën e tij, dhe stampoi të njëjtën aftësi komunikimi, në mënyrë që çdo njeri të jetojë në dhurimin reciprok të vetes.

Modeli i unitetit tonë nuk është gjë tjetër veçse modeli i unitetit që egziston midis Zotit dhe Jezusit.

Cili pra mund të jetë kontributi ynë në përmbushjen e kësaj lutjeje që Jezusi i drejtoi Atit?

Para së gjithash të bëjmë atë që mundemi. Ti japim gojë dhe zemër Jezusit që të vazhdojmë t’ia drejtojmë këto fjalë Atit, duke përsëritur çdo ditë me besim lutjen e tij. Nëse kjo është ëndrra e Hyjit, duam që të jetë edhe ëndrra jonë.

Herë pas herë, përpara çdo vendimi, çdo zgjedhjeje, çdo veprimi, mund të pyesim veten: a shërben kjo gjë për të krijuar “bashkim”.

Si përfundim: Të shkojmë atje ku mosmarrëveshjet janë më të dukshme e t’i marrim mbi vete ashtu siç bënte Jezusi.

“Kërkoj çdo ditë që të bëj timen ëndrrën e Jezusit: Bashkim”

Mund të kemi keqkuptime në familje ose me personat që njohim, tensione që krijohen në lagje, mosmarrëveshje në ambientet e punës, në famulli, ndërmjet kishave.

Mos iu ikni mosmarrëveshjeve dhe keqkuptimeve, mos qëndroni indiferent, por ofroni dashurinë e vërtetë duke dëgjuar, duke u kujdesur për njëri-tjetrin, **duke bashkëndarë dhimbjen që krijohet nga kjo përçarje.**

E mbi të gjitha të jetojmë në unitet me të gjithë ata që janë të gatshëm për të ndarë idealin e Jezusit dhe lutjen e tij duke kujtuar që : **«është më mirë të jesh më pak perfekt në bashkim, sesa shumë perfekt në përçarje»**

“Ku mund të jem përçues i Bashkimit: në familje, shkollë, me miqtë?”